

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6741  
E mërkurë, 26 tetor 2022  
çmimi 0.40 €

## Sunak emërohet kryeministër i Britanisë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PËRFAQËSUESIT E SHITETIT TË KOSOVËS NUK MARRIN PARASYSH KËRKESËN E SHBA-së DHE BE-së PËR SHTYRJEN E VENDIMIT PËR TARGAT SERBE

## KURTI SHPËRFILL KËRKESËN E SHBA-SË DHE TË BE-SË PËR SHTYRJEN E VENDIMIT PËR TARGAT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dalë kundër kërkesës së ShBA-së dhe të BE-së për shtyrjen e afatit për konvertimin e targave të veturave serbe në RKS. Kurti ka bërë me dije se nuk do të ketë shtyrje të afatit për targa. "Ne tashmë e kemi bërë një shtyrje të afatit më 31 korrik. E kemi shtyrë afatin për një muaj dhe në vend se të jetë data 1 tetor, është data 1 nëntor. Të

gjithë qytetarët e Kosovës që kanë automjetet me targa të kohës së Millosheviqit do të mund t'i konvertojnë ato në targa legale e legjitime - RKS", ka thënë Kurti të martën. Edhe presidentja Vjosa Osmani para disa ditësh ka thënë se ka pasur mjaftueshëm afat që serbët t'i konvertojnë targa të veturave të tyre në RKS

## FORCAT USHTARAKE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË KOORDINOHEN PËR THELLIM TË BASHKËPUNIMIT



AMBASADORI I SHBA-SË: DUAM QË DIALOGU TË PËRFUNDOJË DHE KOSOVA TË JETË PJESË E NATO-s

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### AKTUALE



SVEÇLA: ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT ME FROTNEK, EUROPOL E INTERPOL, I NEVOJSHËM F. 3

TË ENJTEN SEANCA E RADHËS F. 6

ABAZI: NË FUND TË VITIT PRESIM DINAMIZIMIN E PROCESIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE F. 7

### EKONOMI



NË MUAJIN SHTATOR NGA SKEMA E NDIHMËS SOCIALE PËRFITUAN 24 169 FAMILJE F. 8

KURTI THOTË SE KANË KRIJUAR MBI 25 000 VENDE TË REJA TË PUNËS F. 8

### SPORT



BALLKANI - SLAVIA PRAHA, CAKTOHEN GJYQATARËT E NDESHJES F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Sunak emërohet kryeministër i Britanisë

LONDËR, 25 TETOR - Rishi Sunak zyrtarisht u emërua në pozitën e kryeministrit të Britanisë, duke zëvendësuar Liz Truss, e cila dha dorëheqje javën e kaluar.

Truss dha dorëheqje pas 44 ditësh si kryeministre, pasi një program ekonomik që ajo prezantoi, shkaktoi trazira në

tregjet financiare, duke bërë që ta humbiste mbështetjen e Partisë Konservatore.

Sunak, ish-ministër i Financave, është kryeministri i parë i Britanisë me prejardhje indiane. Më 25 tetor Mbreti Charles III e ftoi Sunakun që ta formojë qeverinë e re britanike. Sunak, multimilioner dhe ish-

drejtues i fondeve investuese, ka thënë para ligjvënësve të Partisë Konservatore më 24 tetor, se Britania përballet me "krizë ekzistenciale" dhe "ne duhet të bashkohemi ose të vdesim". Sipas tij, Britania po përballet me sfida të mëdha ekonomike, prandaj ka thënë se duhet stabilitet dhe unitet.

## Zelensky: Rusia ka shkatërruar mbi një të tretën e sektorit tonë të energjisë

KIEV, 25 TETOR - Raketat ruse dhe sulmet me dronë të prodhuar në Iran kanë shkatërruar mbi një të tretën e sektorit të energjisë së Ukrainës, tha presidenti Volodymyr Zelensky, gjatë një konference më 25 tetor lidhur me rindërtimin e Ukrainës. "Rusia po shkatërron gjithçka, prandaj është shumë e vështirë për ne që ta kalojmë dimrin", tha Zelensky teksa iu adresua përmes video-lidhjes konferencës në Berlin. Në këtë konferencë morën pjesë kancelari gjerman Olaf Scholz, presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen si dhe zyrtarë të tjerë të lartë.

Von der Leyen tha se sulmet ndaj infrastrukturës civile të Ukrainës përbëjnë "akt të pastër të terrorizimit". Ajo tha se shkalla e shkatërrimit të Ukrainës është "tronditëse", teksa Banka Botërore vlerëson se dëmi total ka arritur në 350 miliardë euro.

Presidentja e KE-së tha se duhet të lansohet një platformë koordinuese për rindërtimin e Ukrainës "sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësi para fundit të vitit apo në fillimit të vitit të

ardhshëm".

Gjatë konferencës Scholz deklaroi se sulmet e vazhdueshme ruse me dronë paraqesin një pikë të re të ulët të luftës së Moskës kundër Ukrainës, por edhe një shenjë të dëshpërimit të Moskës.

Scholz tha se rindërtimi i Ukrainës është një "detyrë brezash" dhe duhet të nisë menjëherë, edhe kur po vazhdon pushtimi rus. "Këtu bëhet fjalë për krijimin e një Plani të ri Marshall për shekullin e 21-të, një detyrë brezash që duhet të nisë tani", tha ai.

Megjithatë, Zelensky tha se Ukraina ende nuk ka pranuar "asnjë cent" për planin e rindërtimit të shpejtë, që është në vlerë prej 17 miliardë dollarësh.

Ai, po ashtu, i kërkoi komunitetit ndërkombëtar që ta mbulojë deficitin buxhetor për vitin e ardhshëm, që pritet të jetë 38 miliardë dollarë.

Ndërkaq, ministri i Komuniteteve dhe Zhvillimit të Territoreve të Ukrainës, Oleksiy Chernyshov, tha se rindërtimi i Ukrainës duhet të nisë tani, kur luftimet po vazhdojnë.



## OKB-ja bën inspektime bërthamore pas pretendimeve ruse për "bombat ndotëse"

NJU-JORK, 25 TETOR - Agjencia Ndërkombëtare për Energji Bërthamore (ANEB) po përgatitet të dërgojë inspektorë në dy ndërtesa bërthamore ukrainase me kërkesë të Ukrainës, pas pretendimeve ruse se Ukraina mund t'i dislokojë të ashtuquajturat "bomba ndotëse", akuza që Kievi i hedh poshtë.

Ukraina dhe aleatët e saj kanë hedhur poshtë pretendimet ruse se Kievi po zhvillon një "bombë ndotëse" për ta përdorur kundër forcave të Moskës dhe ministri i Jashtëm ukrainas, Dmitro Kuleba, ka ftuar ANEB-in "që urgjentisht të dërgojë ekspertë në ndërtesat paqësore në Ukrainë ku Rusia pretendon se po zhvillohet 'bomba ndotëse'".

Kuleba tha se Ukraina gjithmonë ka qenë transparente dhe "nuk ka asgjë për të fshehur".



Në përgjigje të kërkesës së Kulebës, ANEB-i tha se po përgatitet që të dërgojë inspektorë në dy ndërtesa ukrainase.

Shefi i ANEB-it, Rafael Grossi, tha përmes një deklarate se dy lokacionet janë nën mbikëqyrjen

e kësaj agjencie të Kombeve të Bashkuara dhe janë vizituar rregullisht nga inspektorët e agjencisë.

ANEB-i "është i vetëdijshëm për deklaratat e bëra nga Federata Ruse [më 23 tetor] lidhur me aktivitetet e supozuara në dy

lokacione bërthamore në Ukrainë", tha Grossi dhe shtoi se këto dy lokacione kanë qenë subjekt i inspektimeve dhe njëri prej tyre ishte inspektuar muajin e kaluar dhe nuk është gjetur asnjë aktivitet i padeklaruar bërthamor apo ndonjë material. "ANEB-i po përgatitet të vizitojë këto lokacione në ditët në vijim", u tha në deklaratë.

Pretendimet e Rusisë se Kievi po planifikon të dislokojë "bombë ndotëse" - që është një bombë konvencionale, por e mbushur me materiale radioaktive, biologjike dhe kimike, erdhën pas një sërë bisedash telefonike që ka zhvilluar ministri i Mbrojtjes i Rusisë, Sergei Shoigu, me homologët e tij nga disa shtete të NATO-s.

Britania, Franca dhe Shtetet e Bashkuara lëshuan një deklaratë

të përbashkët duke hedhur poshtë pretendimet, pas bisedave me Shoigu, në të cilat ministri rus nuk dha dëshmi për këtë pretendim. "Shtetet tona e kanë bërë të qartë se ne të gjithë hedhim poshtë pretendimet e rreme të Rusisë se Ukraina po përgatitet të përdorë 'bombë ndotëse' në territorin e saj", u tha në deklaratën e këtyre tri shteteve.

Por, Rusia ka përforcuar pretendimin e saj, që vjen disa javë pasi ushtria e Moskës po pëson humbje në jug dhe lindje të Ukrainës. "Sipas informacioneve që kemi, dy organizata në Ukrainë kanë instruksione specifike për të krijuar të ashtuquajturat 'bomba ndotëse'. Kjo punë është në fazën finale", tha gjeneraljejtënant Igor Kirillov më 24 tetor.

SHEFI I SHTABIT I FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË VIZITON KOSOVËN

# Forcat ushtarake të Kosovës dhe të Shqipërisë koordinohen për thellim të bashkëpunimit

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletjënant Bashkim Jashari dhe shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH), gjeneralbrigade Arben Kingji, gjatë takimit të përbashkët në Prishtinë, kanë shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi bilateral mes dy forcave të thellohet edhe në fusha të tjera ushtarake, që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të reja për FSK-në

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 25 tetor - Me nderimet më të larta ushtarake, të martën në Ministrinë e Mbrojtjes për vizitë zyrtare ka ardhur shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjeneralbrigade Arben Kingji, me delegacionin e lartë të FARSH-it, i cili është pritur nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Bashkim

Jashari dhe delegacioni i lartë i FSK-së. Me këtë rast, gjeneral Jashari shprehu mirënjohje të lartë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nën lidhshiripin e gjeneral Kingjit, për kontributin e veçantë në zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së, veçanërisht në fushën e arsimimit dhe stërvitjes. Gjeneral Kingji ka shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi



bilateral mes dy forcave tona të thellohet edhe në fusha të tjera ushtarake, që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të reja për FSK-në. Pas takimit në mes të gjeneral Jasharit dhe gjeneral Kingjit si dhe dy delegacioneve respektive, gjeneral Kingji u prit në takim të veçantë edhe nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Me këtë rast, ministri Mehaj i shprehu gjeneral Kingjit falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen vëllazërore të ofruar në të gjitha periudhat e ndërtimit, zhvillimit si dhe në të gjitha të arriturat e deritashme të vendit, sikur edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Gjithashtu, Mehaj i shprehu mirënjohjen e lartë për rolin dhe kontributin e madh të Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i

NATO-s në sigurinë e përgjithshme të rajonit dhe më gjerë me pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse, e shumë të rëndësishme edhe pjesëmarrjen e fuqishme në kuadër të KFOR-it në vendin tonë. Ndër të tjera, ministri Mehaj ritheksoi edhe rëndësinë shumë të madhe që ka mbështetja e Ministrisë dhe Forcave të Republikës së Shqipërisë, duke pasur parasysh përvojën e madhe në procesin e integrimi euroatlantike si dhe në ngritjen dhe zhvillimin e operacjonalitetit ushtarak në përgjithësi. Në kuadër të vizitës, gjeneral Kingji ka vizituar edhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku është njoftuar me të arriturat e deritashme, sfidat dhe aktivitetet e planifikuara të FSK-së për të ardhmen.

## Sveçla: Zgjerimi i bashkëpunimit me Frotnex, Europol e Interpol, i nevojshëm

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, po merr pjesë në punimet dyditore të Ministerialit të Katërt të Procesit të Pragës "Partneriteti i Migracionit - Rruga përpara në kohë sfidash të reja", i cili po mbahet në Pragë. Me këtë rast, ministri Sveçla para të pranishmëve ka paraqitur rezultatet që Republika e Kosovës ka shënuar në fushën e menaxhimit dhe luftimit të migracionit të paligjshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare si në fushën e zhvillimit të politikave, po ashtu edhe në luftimin e kontrabandës me migrant, ku vetëm këtë vit Policia e Kosovës ka arrestuar 50

persona dhe ka identifikuar 288 viktima. Gjatë adresimit të tij, Sveçla ka vënë në dukje angazhimet që janë duke u bërë në rritjen e efikasitetit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së vijës kufitare me qëllim të rritjes së sigurisë në përgjithësi si dhe parandalimit dhe luftimit të të gjitha llojeve të veprimtarive ilegale që bëhen përgjatë kufirit. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për ndikimin e luftës në Ukrainë si pasojë e agresionit rus, ku ministri Sveçla ka potencuar se, përkundër pozitës gjeografike, gjendja e migrimit të Kosovës nuk preket në shkallë të gjerë nga lufta në Ukrainë. "Qeveria e Kosovës ka treguar gatishmërinë e saj për të strehuar 5 000 refugjatë të Ukrainës si dhe Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën e cila dënon



ashpër agresionin e paligjshëm, të padrejtë dhe të paprovokuar dhe pushtimin e Ukrainës nga Rusia", ka theksuar ministri Sveçla. Në përfundim të rezymesë së tij,

ministri Sveçla ka kërkuar që për kontroll të efektshëm të kufirit, sidomos të vijës kufitare të gjelbër, nevoja për mbështetje me pajisje moderne, si dhe mbështetje për

zgjerimin e bashkëpunimit me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të tilla si Frotnex, Europol, Interpol, është më se e nevojshme.



PËRFAQËSUESIT E SHTETIT TË KOSOVËS NUK MARRIN PARASYSH KËRKESËN E SHBA-së DHE BE-së PËR SHTYRJEN E VENDIMIT PËR TARGAT SERBE

# Kurti shpërfill kërkesën e ShBA-së dhe të BE-së për shtyrjen e vendimit për targa

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dalë kundër kërkesës së ShBA-së dhe të BE-së për shtyrjen e afatit për konvertimin e targave të veturave serbe në RKS. Kurti ka bërë me dije se nuk do të ketë shtyrje të afatit për targa. “Ne tashmë e kemi bërë një shtyrje të afatit më 31 korrik. E kemi shtyrë afatin për një muaj dhe në vend se të jetë data 1 tetor, është data 1 nëntor. Të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë automjetet me targa të kohës së Millosheviqit do të mund t’i konvertojnë ato në targa legale e legjitime - RKS”, ka thënë Kurti të martën. Edhe presidentja Vjosa Osmani para disa ditësh ka thënë se ka pasur mjaftueshëm afat që serbët t’i konvertojnë targa e veturave të tyre në RKS

**EPOKA  
ERE**

Lirim GECI

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk e ka marrë parasysh kërkesën e partnerëve strategjikë të shtetit tonë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian, për ta shtyrë edhe për dhjetë muaj vendimin për konvertimin e targave serbe në RKS.

Kurti të martën në një prononcim para medieve ka konfirmuar se nuk do të ketë shtyrje të afatit për targa. “Ne tashmë e kemi bërë një shtyrje të afatit më 31 korrik. E kemi shtyrë afatin për një muaj dhe

në vend se të jetë data 1 tetor, është data 1 nëntor. Të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë automjetet me targa të kohës së Millosheviqit do të mund t’i konvertojnë ato në targa legale e legjitime - RKS”, ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve serbë që ta shfrytëzojnë kohën e mbetur për t’i konvertuar targa ilegale në RKS. “Fushata vazhdon, përmes medieve, takimeve me të gjithë aktorët që targa RKS të shtohen e ato KM të hiqen. Ne bëjmë më të mirën e mundshme duke mos kursyer energjinë. Këto nuk janë masa kundër serbëve, por për serbët. Jemi të interesuar që të gjithë të jemi të barabartë. Nuk është as

hakmarrje, as inat, as urrejtje, por zbatim i ligjit. Kur aleatët e partnerët tanë na japin sugjerime, ne i marrim ato shumë seriozisht dhe i analizojmë me kujdes”, ka deklaruar Kurti.

Ndërsa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kishte thënë më 23 tetor se ka pasur mjaftueshëm afat që serbët t’i konvertojnë targa e veturave të tyre në RKS. Këtë deklaratë shefja e shtetit e kishte dhënë kur i është kërkuar përgjigje lidhur me kërkesën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ky afat të mos përfundojë në fund të këtij muaji, siç është paraparë, por të shtyhet edhe për 10 muaj. “Çështja e targave

mbi të gjitha është çështje e sundimit të ligjit, sepse mbi 90 për qind e serbëve që jetojnë në Kosovë tashmë i kanë konvertuar targa e së kaluarës në targa të ligjshme. Pra, e kanë respektuar ligjin dhe njëkohësisht kanë kontribuar në sundim të ligjit dhe në trajtim të të gjithëve në mënyrë të barabartë para ligjit”, kishte thënë Osmani.

Po ashtu, shefja e shtetit kishte thënë se konvertimi i targave është në përputhje me legjislacionin vendor dhe praktikën ndërkombëtare. “Sa i përket një pakice të vogël që nuk i ka konvertuar ende targa dhe i përdorë targa të kohës së Millosheviqit, kërkesa jonë është që të respektohet ligji. Ka pasur afat të mjaftueshëm që ky konvertim të bëhet për këtë numër të vogël të qytetarëve që nuk e kanë bërë, në përputhje të plotë me atë që e kërkon legjislacioni vendor, por edhe praktikën ndërkombëtare”, ka thënë ajo.

Presidentja Osmani kishte marrë shembull Poloninë, sikur aty 20 vjet pas luftës të qarkullonin ende automjete me

targa të kohës së Hitlerit. Të kesh automjetet me targa të kohës së Millosheviqit si qytetar i Kosovës, Osmani ka thënë se është “jo vetëm e paligjshme”, por “edhe e pamoralshme”.

Emisari special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, javën e kaluar ka vizituar Kosovën, ku ka bërë me dije se i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës ta shtyjë edhe për 10 muaj afatin për konvertimin e targave.

Në anën tjetër, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka vazhduar propagandën kundër vendimit të Kosovës që serbët t’i konvertojnë targa në RKS. Vuçiqi ka thënë të martën se Quint-i i ka kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, që ta shtyjë vendimin për targa, por ai ka qenë kundër. “Na presin kohë të vështira. Do të jemi me serbët në Kosovë, të cilët kanë treguar se nuk duan ta dëgjojnë Kurtin e as të tjerët, por veten dhe ndërgjegjen e tyre”, ka thënë Vuçiqi.

I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, javën e kaluar ka qenë

## KOMF-i mban konferencën nacionale “Sot flas unë!”

PRISHTINË, 25 TETOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF) ka mbajtur të martën konferencën “Sot flas unë!”.

Në këtë konferencë patën rastin të flasin përfituesit e shërbimeve sociale, fëmijë dhe prindër, të cilët ndan sfidat e tyre si pasojë e mungesës së shërbimeve dhe nevojës për shërbime sociale të qëndrueshme e cilësore, sidomos pas situatës së rënduar nga pandemia Covid-19.

Fëmijë dhe prindër ndan vështirësitë për marrjen e shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, fëmijë viktime të përdorimit të substancave narkotike, martesat e hershme etj. Në këtë konferencë, po ashtu, patën fjalë rasti Avokati i Popullit,

Naim Qelaj dhe përfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian, Samir Selimi.

Rekomandimi kryesor nga konferenca ishte miratimi i Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe cilësore.

Ky aktivitet mundësohet në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, i cili implementohet nga koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF) në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP.



## Rizvanolli në takimin e ministrave të Energjisë kërkon përkrahje financiare për Kosovën



BERLIN, 25 TETOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka marrë pjesë në takimin e ministrave të Energjisë të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, me ftesë të zëvendëskancelarit gjerman dhe ministrit për Çështje Ekonomike dhe Veprim Klimatik, Robert Habeck.

Gjatë takimit ministrja Rizvanolli ka ngritur çështjet e nevojat kritike për Republikën e Kosovës për t'u përballur me krizën energjetike evropiane.

Në takim u theksua se përballja me këtë krizë ka rëndësi përtej

mbrojtjes së klimës e ambientit dhe është çështje e sigurisë. Prandaj, hapat që duhet ndërmarrë për t'u përballur me këtë krizë shtrihen përtej kufijve.

Për ta zvogëluar ndikimin e krizës evropiane te qytetarët e Republikës së Kosovës, ministrja Rizvanolli ka ritheksuar nevojën për fonde domethënëse nga Gjermania e Bashkimi Evropian, si dhe ka kërkuar mbështetje e kontribut për zgjerim të masave për efikasitet të energjisë në sektorin e banimit, ngrohje qendrore, si dhe kapacitete të reja gjeneruese të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

për vizitë në Kosovë, ku është takuar me liderët institucionalë dhe partiakë. Ai ka bërë me dije ka kërkuar nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri, të shtyhet vendimi për targarat. “Nuk është sekret që ne kemi kërkuar një periudhë më të gjatë të zbatimit, dhe kemi kërkuar edhe 10 muaj të tjerë. Do të doja ta shihja këtë që të ndodhte. Kjo nuk është vetëm kërkesë e ShBA-së, por e gjithë Quint-it. Dhe, kjo është për shkak se ne jemi shtetet që e përkrahim më së shumti Kosovën. Besojmë se është e rëndësishme që kur ne bëjmë rekomandime, njerëzit t'i dëgjojnë ato”, kishte thënë Escobari në një intervistë për “Kanal10”.

Edhe Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar që të shtyhet vendimi për targarat serbe. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka theksuar se kjo shtyrje do të mundësonte një fushatë informative dhe konsultime më thelbësore. “Sipas marrëveshjeve të dialogut për lirinë e lëvizjes nga viti 2011 dhe 2016, është e rëndësishme që t'i jepet kohë e

mjaftueshme zbatimit të këtij plani dhe të përgatitet dhe zbatohet në konsultim të ngushtë me qytetarët e prekur dhe në përputhje me praktikën e Evropiane. Konkluzionet e lirisë së lëvizjes nga viti 2016 përfshinin afate kohore për reregjistrim, të cilat duhet të ofrojnë udhëzime. Prandaj, që nga fillimi i këtij procesi, ne i kemi rekomanduar Qeverisë së Kosovës që të vendosë një periudhë 12-mujore për reregjistrim. Duke ndjekur të njëjtin arsyetim, tani po kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që ta shtyjë afatin ekzistues për 10 muaj. Kjo shtyrje do të mundësonte një fushatë informative dhe konsultime më thelbësore dhe gjithëpërfshirëse me popullsinë e prekur”, ka thënë Stano për “TV Dukagjinin”.

Sipas tij, kjo, gjithashtu, do t'i mundësonte Kosovës që të gjithë serbëve të Kosovës në veri t'u lëshohen letërnjoftime dhe patentë shoferi i Kosovës. Stano ka potencuar se duhet të shmanget eskalimi i tensioneve dhe situatës në veri të vendit.

## Tahiri: Secili veprim i Kosovës në raport me Serbinë duhet të koordinohet me ShBA-në

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se çfarëdo veprimi të cilin e ndërmerr qeveria për çështjen e targarave dhe që respekton sovranitetin e vendit, e ka përkrahjen e kësaj partie. Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Tahiri, ka thënë se secili veprim i Qeverisë së Kosovës në raport

me atë të Serbisë është i rëndësishëm që të koordinohet me ShBA-në. “Secili veprim i Qeverisë së Republikës së Kosovës që do të ndërmerret në raport me Republikën e Serbisë, padyshim se është shumë e rëndësishme që të koordinohet me ShBA-në, mirëpo më e rëndësishmja është që ky koordinim të

rezultojë me respektimin dhe sovranitetin e Kosovës. Nuk mund të lejohet pafundësisht shfrytëzimi i targarave të tilla dhe besoj se çfarëdo veprimi të cilin e ndërmerr Qeveria e Kosovës e që respekton sovranitetin e vendit tonë edhe në atë pjesë të Kosovës, padyshim se do ta ketë përkrahjen e PDK-së”, ka thënë Tahiri.

“Duhet të shmanget përkallëzimi i tensioneve dhe, potencialisht, dhuna në veri të

Kosovës. Kjo është e një rëndësie të veçantë në kontekstin aktual gjeopolitik, në

funkcion të ruajtjes së stabilitetit në rajon”, ka thënë zëdhënësi i BE-së.

# Të enjten seanca e radhës, në rend dite Projektligji për masat e përkohshme të produkteve themelore



EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 TETOR - Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e paraparë për të martën, nuk është mbajtur në mungesë të kuorumit. Megjithatë, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në bazë të vendimit të Kryesisë të mbledhjes së kaluar, konform kompetencave të tij kushtetuese dhe në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbledhet në seancë plenare të enjten në orën 10:00. Pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe

pyetjeve parlamentare, në këtë seancë deputetët pritet ta votojnë në parim Projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, Projektligjin për mbështetjen e punëve publike, si dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Noterinë.

Në lexim të dytë, ndërkaq, pritet të votohet Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Pikë e radhës e rendit të ditës do të jetë votimi i rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës për

vitin 2021 dhe Raportit të Auditimit të performancës "Menaxhimi i fondeve publike në Radiotelevizionin e Kosovës", për të vijuar me shqyrtimin e Propozimrezolutës

kundër sulmeve ndaj integritetit seksual. Seanca do t'u kthehet sërish projektligjeve, për ta shqyrtuar për herë të parë Projektligjin për faljen e masave ndëshkimore të vendosura gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, si dhe atë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Punimet e seancës plenare do të vazhdojnë me shqyrtimin e raportit vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e Auditimit të Përgjithshëm, për raportin vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, shqyrtimin e raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2021, propozimin e GP "Multietnik" dhe GP të LV-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, për të përfunduar me formimin e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit për Ankesa të Medieve.

## 60 nxënës të shkollave të Gjilanit certifikohen në trajnime të ndryshme

GJILAN, 25 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka shpërndarë certifikata për 60 nxënës të cilët janë trajnuar në fushat përkatëse në kuadër të Javës së Kodimit. Kjo ngjarje shënon përmbylljen e Javës së Kodimit (Eu code week 2022), e cila është organizuar nga Qendra për Edukim në Teknologji Procoders Center dhe komuna e

Gjilanit.

Java e kodimit është mbajtur në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian dhe shtetet që kanë aspirata të jenë pjesë e BE-së, siç është Republika e Kosovës.

Komuna e Gjilanit këtë vit ka qenë qyteti i vetëm në Kosovë që ka organizuar këtë ngjarje me rëndësi për zhvillimin e teknologjisë.



## Ambasada e Turqisë dhuron 200 pako me mjete didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta

PRIZREN, 25 TETOR - Ambasada e Turqisë në Kosovë ka dhuruar të martën 200 pako me mjete didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta.

Drejtoresha e Arsimit në Prizren, Luljeta Veselaj-Gutaj, ka theksuar se komuna e Prizrenit është e përkushtuar dhe punon për të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë fëmijëve pa dallim. Në këtë kontekst, ajo

ka thënë se roli i mësuesve të arsimit special është sa jetik, aq dhe fisnik. "Çdo vit po rritet numri i asistentëve mbështetës në shkollat e komunës së Prizrenit, që është tregues domethënës që dëshmon seriozitetin për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe integrimin e tyre në shoqëri", ka thënë drejtoresha Veselaj-Gutaj.

## Një i vdekur dhe gjashtë raste të reja në 24 orë e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 25 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije të martën se në 24 orët e fundit është konfirmuar një

rast i vdekjes nga Covid-19. Ndërkaq, pas 55 testeve, janë konfirmuar 6 raste të reja me Covid-19.

Sipas raportit të MSh-së, një pacient është shëruar nga ky virus.

Raste aktive me Covid janë

21.

Në 24 orët e fundit vaksinën kundër Covidit e kanë marrë 23 qytetarë.



# Ambasadori i ShBA-së: Duam që dialogu të përfundojë dhe Kosova të jetë pjesë e NATO-s

PRISHTINË, 25 TETOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë për synim që vendet e Ballkanit Perëndimor të mos mbesin jashtë Evropës. Ai në hapjen e Samitit të Ballkanit Perëndimor "The Western Balkans Summit 2022", i cili po mbahet në Prishtinë, ka theksuar se qëllimi strategjik i ShBA-së është që në vendet e rajonit dhe më gjerë të mbizotërojë paqja. Ambasadori amerikan shtoi se: "Dëshirojmë që të kemi një integrim më të lartë ekonomik dhe duam t'ju ndihmojmë që të veprojnë përtej kufirit". "Ne në tërë rajonin kemi shumë programe. Këtu në Kosovë kemi tri qëllime strategjike, pra ne e mbështesim Kosovën që të integrohet në vendet euroatlantike. Kjo merr kohë. E dyta ka të bëjë me rritjen ekonomike dhe zhvillimin, e duhet të jenë për të gjithë. Kurse e fundit është sundimi i ligjit. Jeni një shtet që nuk e keni përvojën. Këto janë prioritetet me logjikën evropiane. Ne duam që dialogu të përfundojë dhe që Kosova të jetë pjesë e NATO-s", ka pohuar Hovenier. Ai në Samitin e Ballkanit



Perëndimor shtoi se një numër i presidentëve janë për një Evropë të bashkuar, duke u bërë prioritet që të arrihet kjo. "Prioriteti ynë më i lartë është integrimi i vendeve në Bashkimit Evropian, e që është në interes të vendeve dhe të ShBA-së. Ne mendojmë se çdo vend që është anëtar i BE-së është një vend më demokratik", ka deklaruar Hovenier.

## Abazi: Në fund të vitit presim dinamizimin e procesit të liberalizimit të vizave

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 25 tetor - Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, tha se ka shpresa që deri në fund të vitit Kosova të marrë përgjigje pozitive "sa i përket dinamizimit të procesit të liberalizimit të vizave". "Ajo që është thënë sot është se ky proces do të vazhdojë", ka thënë Abazi. Këtë deklaratë Abazi e bëri pas takimit të anëtarëve të komisionit me ambasadorin e Francës në Prishtinë, Olivier Guerot. Më 13 tetor, në takimin e grupit punues për viza të Këshillit të Bashkimit Evropian, zyrtarët e Francës kushtëzuan procesin e vizave për Kosovën me funksionalizimin e sistemit të sigurisë në Evropë, ETIAS.



Abazi ka thënë se në takimin me ambasadorin francez ky i fundit shprehu mbështetjen për liberalizimin e vizave për Kosovën, por shtoi se ka "disa shqetësime që duhet të adresohen". "Kemi argumentuar për atë se çfarë do të thotë për qytetarët e Kosovës që ky proces të mos ketë qartësinë e plotë.

Kemi marrë përgjigje, gjithashtu. Është një klub i shteteve të BE-së që po bën negociatën për të gjitha aspektet, përfshirë edhe ETIAS si sistem që jo domosdo e prek vetëm Kosovën, por e prek edhe Kosovën. Sërish kemi argumentuar në nivelin e asaj se çfarë qytetarët kosovarë presin nga ky proces", ka deklaruar

Abazi.

Sistemi ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit. Ky sistem elektronik mundëson verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta, që nuk kanë nevojë për vizë, për të hyrë në Zonën Shengen.

Procedura ligjore për ta miratuar këtë sistem ka nisur më 2016 dhe sistemi pritet të jetë plotësisht operacional brenda vitit 2023, pa ndonjë datë të saktë.

Komisioni Evropian ka rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën më 2018.

Zyrtarët shtetërorë në Kosovë kanë thënë se do të ishte e padrejtë që të vendosen kushte të reja në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Qytetarët e Kosovës janë të vetmit në rajon që i nënshtrohen regjimit të vizave gjatë udhëtimit

në Zonën Shengen.

Një ditë më parë raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se një vendim për liberalizimin e viza për Kosovën pritet të merret kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit, duke theksuar se shpreson që ky vendim të jetë pozitiv.

Në një konferencë për medie në Prishtinë, Von Cramon ka thënë se shpreson që të mos vendosen kushtëzime apo që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me ndonjë metodologji të re të Bashkimit Evropian. "Vendimi do të jetë dikur kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit. Por, pyetja është se a do të çojë të një sistem i ri i kushteve për vizat, që do të ishte krejtësisht i padrejtë, apo përfundimisht do të shohim një datë për vizat", ka theksuar Von Cramon.

## Sokol Havolli zgjedhet kryeshef i "Prishtina Parking"

PRISHTINË, 25 TETOR - "Prishtina Parking" ka publikuar të martën rezultatet finale për kryeshef ekzekutiv të kësaj ndërmarrje publike. Në listën e publikuar nga kjo kompani në "Facebook", prin Sokol Havolli me 38.75 pikë, pastaj Qëndrim Vitija me 35.25 pikë,

Gazmend Rexhepi me 32.50 pikë, Isat Rakovica me 28 pikë dhe Nexhmi Uka me 24.50 pikë. Siç shkruhet në njoftim, kandidati potencial me mundësi zgjedhje në këtë pozitë është ai që ka fituar më së shumti pikë. "Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, sipas rezultatit të treguar

gjatë procedurave rekrutuese dhe në bazë të dokumentacionit që posedon, si kandidat potencial dhe me mundësi zgjedhje për këtë vend pune, cakton kandidatin me më së shumti pikë", thuhet në njoftimin e "Prishtina Parking".



## Kurti thotë se kanë krijuar mbi 25 000 vende të reja të punës

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se me qeverinë e drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, Kosova ka bërë hapa të mëdhenj drejt demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik. "Me qeverinë tonë Kosova ka bërë hapa të mëdhenj drejt demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik. Jemi numër një në rajon sa i përket sundimit të ligjit. Autoritetet ligjzbatuese kanë ndërmarrë

800 operacione ndaj krimit dhe korrupsionit duke arrestuar rreth 2 000 njerëz, përfshirë 300 zyrtarë publikë dhe shtetërorë. Kanë shkatërruar 68 banda kriminale dhe kanë konfiskuar mbi 1.8 milion tonë drogë. Vetëm javën e kaluar janë sekuestruar 75 vila të ndërtuara paligjshëm në një Park Nacional. Lista e pronarëve aty ishte tronditëse, por jo befasuese: gjyqtarë të nivelit të lartë, biznesmenë të pasur, politikanë dhe të afërmit e tyre", është shprehur kryeministri

Kurti.

Ai ka theksuar se epoka e korrupsionit në Kosovë dhe e mosndëshkueshmërisë në nivelin e lartë po përfundon. "Nga ana tjetër, vitin e kaluar e përfunduar me 10.7 për qind rritje për bruto-produktin vendor. Investimet e huaja direkte janë rritur. Kemi krijuar mbi 25 000 vende të reja të punës dhe buxheti është më i madhi në histori të vendit tonë", ka thënë Kurti në Samitin e Ballkanit Perëndimor që po mbahet në Prishtinë.



## Në muajin shtator nga skema e ndihmës sociale përfituan 24 169 familje

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin shtator 2022 për numrin e përfituesve nga skema e ndihmës sociale, skema e pensione bazë të moshës, të pensioneve kontributpaguese të moshës, skemën e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, skemën e pensioneve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për pensionet familjare, skemën për pensionet invalidore, skemën e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës, skemën e pensioneve të Trepçës, skemën e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, skemën e kompensimeve për personat e verbër, të dhëna për numrin e fëmijëve të braktisur etj.

Sipas rezultateve të dala nga ky publikim, rezulton se gjatë muajit shtator 2022: nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 24 169 familje, me gjithsej 95 478 anëtarë, dhe nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë



fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 776 familje. Ndërkaq, nga skema e pensioneve bazë të moshës janë 140 800 përfitues; nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës janë 48 456 përfitues; nga skema për pensionet familjare

janë 3 311 përfitues; nga skema për pensionet invalidore janë 61 përfitues; nga skema për pensionet e Trepçës janë 1 803 përfitues; nga skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës janë 1 267 përfitues; nga skema e pensioneve për

Forcën e Sigurisë së Kosovës janë 677 përfitues; nga skema e kompensimeve për personat e verbër janë 1 823 përfitues; nga skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara janë 18 998 përfitues; nga skema për pensionet e personave paraplegjik dhe

tetraplegjik janë 2 537 përfitues; nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës janë 13 148 përfitues; dhe nga skema për veteranët e luftës janë 36 780 përfitues. Ndërsa gjatë muajit shtator 2022 janë braktisur dy fëmijë.

## Prodhimi i thëngjillit për muajin gusht ishte rreth 5.73 mijë tonë

**PRISHTINË, 25 TETOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) çdo muaj publikon të dhënat për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore për muajin gusht 2022.

Në muajin gusht 2022 prodhimi

bruto nga termocentralet i energjisë elektrike ishte 447.18 GWh, prodhimi bruto nga hidrocentralet energjisë elektrike ishte 4.37 GWh dhe prodhimi bruto nga era dhe ajo solare e energjisë elektrike ishte 20.49 GWh.

Gjatë muajit gusht 2022 energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 460.24 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 363.42 GWh, ose 9.66 për qind më i vogël sesa në muajin e njëjtë të vitit

paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 6.84 për qind.

Importi i energjisë elektrike në muajin gusht ishte 355.24 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 367.03 GWh.

Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 5.73 mijë tonë, ose 2.49 për qind më pak sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak.





# Epoka e re, në të cilën armët bërthamore do të luajnë një rol më të madh



## Nga Richard HAASS

Armët bërthamore kanë qenë një faktor thelbësor në marrëdhëniet ndërkombëtare që nga gushti i vitit 1945, kur Shtetet e Bashkuara hodhën dy prej tyre mbi Japoni për të përshpejtuar përfundimin e Luftës së Dytë Botërore.

Asnjë armë e tillë nuk është përdorur që nga ajo kohë, dhe ndoshta kjo gjë ndihmoi në mbajtjen e "ftohtë" të Luftës së Ftohtë, duke imponuar një shkallë të lartë të kujdesit në të dy anët e konfrontimit midis SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik.

Për më tepër, negociatat mbi kontrollin e armëve të tilla, patën sukses në kufizimin e arsenalit bërthamor të të dyja vendeve, dhe ndalën ose ngadalësuan përhapjen e tyre. Sot, vetëm 7 vende të tjera (Britania e Madhe, Franca, Kina, Izraeli, India, Pakistani dhe Koreja e Veriut) zotërojnë armë bërthamore. Tani pyetja është nëse jemi në pragun e një epoke të re të zgjerimit të arsenaleve bërthamore, të një roli më të spikatur të tyre në gjeopolitikë, dhe të përpjekjeve të më shumë vendeve për t'i blerë ato. Rrezikut i shtohet ndjenja se tabuja bërthamore kundër zotërimit apo edhe përdorimit të armëve bërthamore po zbehët ndjeshëm, për shkak të kalimit të kohës dhe shfaqjes së një gjenerate të re të së ashtuquajturave armë bërthamore taktike, që nënkuptojnë pasoja më pak katastrofike dhe që për këtë arsye mund të duken si më të përdorshme.

Lufta e Rosisë kundër Ukrainës, e ka bërë më të mundshme ardhjen e kësaj epoke të re. Dhe kjo në disa mënyra. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, Ukraina ia dorëzoi Rosisë armët bërthamore që mbetën në territorin e saj në këmbim të garancive të sigurisë. Që nga ajo kohë, Rusia e ka pushtuar dy herë, një fakt që mund të bindë të tjerët se heqja dorë nga armët bërthamore e vë në rrezik sigurinë e një vendi.

Më pas, në vazhden e pushtimit të dytë të Rosisë në fillim të këtij viti, SHBA-ja përjashtoi përfshirjen e drejtpërdrejtë ushtarake në krah të Ukrainës, për shkak të shqetësimit se dërgimi i trupave amerikane në terren, apo krijimi i një zone ndalim-fluturimi mund të çojë në shpërthimin e një Luftë të Tretë Botërore që do të jetë me siguri bërthamore.

Kina dhe vendet e tjera, mund ta shohin këtë si një dëshmi të qartë se zotërimi i një arsenali të madh bërthamor që mund të pengojë SHBA-në, ose të paktën ta nxisë atë të veprojë me një vetëpërmbytje më të madhe. Pas dështimeve serioze në fushën e betejës, presidenti rus Vladimir Putin ka kërcënuar se do të përdorë armët bërthamore brenda ose afër Ukrainës, në një përpjekje për të frikësuar ukrainasit, dhe për t'i detyruar qeveritë evropiane dhe SHBA-në që të ri-mendojnë mbështetjen e tyre për këtë vend.

Edhe zhvillimet diku tjetër kanë ndikuar për ri-mendimin e vlerës së armëve bërthamore. Regjimet dhe udhëheqësit në Irak dhe Libi u

rrezuan, pasi braktisën programet e tyre të armëve bërthamore, dhe kjo mund t'i shtyjë të tjerët të marrin në konsideratë avantazhet e mbajtjes apo zhvillimit të aftësive bërthamore.

Nga ana e saj Koreja e Veriut, qëndron e qetë pasi po vazhdon ta zgjerojë arsenalin e saj bërthamor. Po ashtu bota ka mësuar të jetojë me arsenalet bërthamore izraelite, indiane dhe pakistaneze. Ekziston rreziku që më shumë armë bërthamore nga më shumë vende, të rrisin shanset e përdorimit të një ose më shumë nga këto armë me një forcë shkatërruese të paimagjinueshme.

Dhe ne nuk mund ta marrin të mirëqenë se mbi to do të ketë një kujdes të përgjegjshëm. Ndërkohë zotërimi i armëve bërthamore ka po ashtu potencialin për të siguruar një lloj mburoje, që mund ta bëjë më të zakonshëm agresionin jobërthamor.

Madje edhe vetëm besimi se një vend po shkon drejt prodhimit të armëve bërthamore, mund të shkaktojë veprime ushtarake nga fqinjët e shqetësuar, duke çuar ndoshta në një konflikt më të madh. Duke pasur parasysh këto rreziqe, detyra më emergjente është të mos biem pre e kërcënimeve bërthamore të Putinit, pasi kjo mund të krijojë një precedent të rrezikshëm. Dhe kjo qasje kërkon ruajtjen e mbështetjes ushtarake dhe ekonomike perëndimore për Ukrainën, si dhe rikujtimin e rregullit ndaj Rosisë nga SHBA dhe aleatët e saj, se pasojat e çdo përdorimi bërthamor të armëve

bërthamore, si për forcat ushtarake ruse në Ukrainë, po ashtu edhe për këdo që është përfshirë në këtë vendim, do të jenë shumë më të mëdha sesa çdo përfitim i perceptuar.

Njëkohësisht, dhe sigurisht para fillimit të vitit 2026, kur skadon traktati NEW START që kufizon arsenalet e dy fuqive të mëdha bërthamore, SHBA duhet t'ia bëjë të qartë Rosisë gatishmërinë e saj për të diskutuar fazën tjetër të kontrollit të armëve bërthamore. Axhendaduhet të përfshijë numrin dhe llojet e sistemeve të armëve që do të kufizohen, por edhe përfshirjen e Kinës.

Së bashku me partnerët e saj në rajon, SHBA duhet gjithashtu të ndërmarrë hapa – diplomatikë ose ushtarakë nëse është e nevojshme – për t'u siguruar që Irani të mos prodhojë armë bërthamore dhe as të afrohet aq shumë sa të mund ta arrijë këtë gjë.

Në rastin e dështimit në këtë aspekt, një ose më shumë nga fqinjët e Iranit mund të vendosin se kanë nevojë për armët e tyre bërthamore. Një skenar i tillë do ta çonte në një drejtëm edhe më të rrezikshëm Lindjen e Mesme, që për 3 dekadat e fundit ka qenë rajoni më pak i qëndrueshëm në botë.

Rigjallërimi i marrëveshjes bërthamore të vitit 2015, që Irani arriti me fuqitë botërore (dhe nga e cila SHBA u tërhoq në vitin 2018) do të ndihmonte vetëm përkohësisht, pasi pakti përmban disa të ashtuquajtura klauzola kufizuese. Por ajo duket si një kosto shumë e lartë për t'u paguar, pasi do t'i jepte

mundësi Iranit t'i jepte fund disa prej sanksioneve më të rëndësishme. Dhe në ato kushte regjimi mund të ndjekë një politikë të jashtme edhe më agresive, dhe të garantojë një kamerdare shpëtimi pikërisht në momentin kur po forcohet opozita e brendshme ndaj tij.

Disa shqetësime të tjera janë në Azi. Përpjekjet për të shkëputur Korenë e Veriut nga armët e saj bërthamore nuk po shkojnë gjëkund. Denuklearizimi i plotë duhet të mbetet një synim, por ndërkohë SHBA, Koreja e Jugut dhe Japonia duhet të marrin në konsideratë edhe një formë propozimi për kontrollin e armëve, e cila do të kufizonte arsenalin bërthamor dhe sistemet raketore të Koresë së Veriut, kjo në këmbim të reduktimit të sanksioneve.

Po ashtu, SHBA duhet gjithashtu të ruajë aleancën e saj të ngushtë me Korenë e Jugut dhe Japoninë përkundrejt jo vetëm Koresë së Veriut, por edhe Kinës. Dështimi për ta bërë këtë do t'i bënte me shumë gjasa që të dyja këto të fundit të rishqyrtojnë mundësinë e heqjes dorë nga armët bërthamore. Për një kohë të gjatë, shumë studiues dhe politikë-bërës kanë vepruar nën iluzionin se problemi bërthamor ishte një relike e Luftës së Ftohtë. Në fakt, bota po i afrohet një epoke, e cila mund të përkufizohet edhe më qartë nga armët bërthamore. Ndryshimi i kursit është i domosdoshëm dhe koha për këtë po mbaron. / "Council on Foreign Relations" – Bota.al

# U detyrova të luftoj për Bosnjën, ndaj e di se ukrainasit mund të fitojnë



Nga: Faruk ŠEHIĆ, poet dhe romancier boshnjak / The Guardian (*titulli origjinal: I had to fight for Bosnia. That's how I know Ukrainians can win, and they will rebuild*)  
Përktheu: Agron SHALA

Ndale cilindo person në rrugë, në Sarajevë, dhe pyete se çka mendon për luftën në Ukrainë. Do të të thotë se mendon se gati gjithçka çfarë ndodhi me luftën në Bosnje-Hercegovinë, tashti po përsëritet në Ukrainë.

Një prill e kemi përkujtuar 30-vjetorin e luftës kundër Bosnjës dhe Hercegovinës. Fillimin e prillit të vitit 1992 e vlerësojmë si momentin kur nisi epoka e re: kishim periudhën para, gjatë dhe pas katastrofës.

Një muaj pas fillimit të luftës në Ukrainë, vërejtja se si ukrainasit nisën ta përdorin shprehjen “para lufte”. Kaluam nëpër gjithçka që po ndodhë sot me ta, por askush nuk po na pyet për këtë, ose nuk dëshiron që ne të ndihmojmë.

Lufta të shtyn të fillosh ta shohësh jetën dhe vdekjen më ndryshe. Para “luftës sonë të vogël” (frazë ironike të cilën e përdor në veprat letrare), doja të bëhesha poet dhe shkrova poezi ultra-metaforike dhe të pakuptueshme. Pas luftës isha i përkushtuar të shkruaja sa më qartë dhe më saktë, sidomos për ngjarjet e luftës. Atëherë u bëra shkrimtar. Lufta ishte përshpejtues gjigant në këtë proces.

Në një artikull të kohëve të fundit, për Paris Review, Ilya Kaminsky citoi poetin ukrainase Daryna Gladun, se si ngjarjet në Ukrainë kishin ndryshuar shkrimin e saj: “I kam lënë mënjanë metaforat, për të folur për luftën me fjalë të qarta”, ka thënë ajo, “në mënyrë që lexuesit anembanë botës të preken nga cinizmi, nga mizoria dhe nga pashmangshmëria e luftës që Rusia solli në Ukrainë”. Një numër

poetësh në Sarajevë zbuluan se e njëjta gjë ndodhi gjatë rrethimit të këtij qyteti – më të gjatit në historinë e luftës moderne. Poeti i famshëm sloven, Tomaž Šalamun, ka thënë një herë se ndaloi së shkruari poezi gjatë tërë luftës në Bosnje.

Më 21 prill 1992 nisi sulmi në qytetin tim të lindjes, në Bosnjën e largët perëndimore. Atë kohë isha duke studiuar në Zagreb, por u ktheva në Bosanska Krupë meqë e dija se lufta do të fillojë shumë shpejt: formacionet e rregullta dhe të parregullta serbe, në fillim të prillit nisën sulmin kundër qyteteve të Bosnjës lindore.

Mund t'i shihje qytetet duke u djegur, përgjatë lumit Drina – kufirit natyror mes Bosnje-Hercegovinës dhe Serbisë, edhe pse vendi ende quhej Republika Federative e Jugosllavisë. Por, as shkronja J nuk i mbeti Jugosllavisë, sepse Sllovenia, Kroacia dhe Bosnje-Hercegovina e shpallën pavarësinë dhe u shkëputën prej saj.

Kur erdhi sulmi, isha duke pirë birrë dhe duke dëgjuar muzikë në tarracën e kafenesë Casablanca në Bosanska Krupë. Mbjaj mend se veshur kisha xhinset Levi's, xhakëtën me pupla dhe atletet Adidas. Ishte ditë e bukur, por pak pas orës 18:00 nisi sulm i artilerisë. Tek atëherë e kuptova se çfarë do të thotë shprehja “në tmerrin vdekjeprurës”. Militantët e Partisë Demokratike Serbe, të ndihmuar nga forcat e ish-Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë, bombarduan qytetin prej kodrave përreth.

As nuk doja vullnetar dhe as nuk jam rekrutuar. Ishim të rrethuar nga forcat armike dhe nuk kishte rrugëdalje prej kësaj zone (më vonë u quajt Xhepi i Bihazit ose Qarku i Bihazit), pos nëse do të mund të fluturoje. I kapa armët sepse më dëbuan nga banesa, nga rruga dhe nga lagjja ime. Ndërgjegjja ime më urdhëroi të luftoj.

Për 44 muaj kam luftuar si ushtar e më vonë si oficer, duke e drejtuar –

në fund të luftës – një njësit prej 130 vetash në operacionet më të vështira luftarake. Një herë u plagosa rëndë në këmbën e majtë dhe, për të ecur, për gjashtë muaj rresht kisha nevojë për paterica. Dhimbja ishte pak a shumë e durueshme, sepse isha i ri dhe trupi e kishte forcën e çelikut. Atëherë nuk kishim kohë që të mendojmë për tejkalimin e dhimbjes, as për të menduar për veten.

Mbjaj mend se duhej të shkoja në tualet me një karrocë të veçantë, që kishte një vrimë në ulëse. Por, u shërova shpejt, u ktheva në repart dhe në të njëjtat detyra që kisha para plagosjes, si komandant i togës prej 30 vetave.

Gjatë luftës, koha kronologjike u ndal së lëvizuri. E mbanim orën në kyçin e dorës, por tregonte një kohë të pakuptimtë. Ishim të shkëputur nga pjesa tjetër e vendit tonë dhe nga bota e qytetëruar. Ishim pesë orë larg me makinë nga Vjena, të paktën para lufte. Atëherë kemi jetuar thuajse jemi në fundin e botës, kështu që koha ishte e parëndësishme. Brenda nesh kalonte një kohë e re – ajo që llogaritet nga momenti kur jeta jote idilike qytetare përmbysset dhe ti bëhesh refugjat. Pas momenteve të para të tronditjes, u ngutëm ta kapim për qafe mënyrën apokaliptike të jetesës.

Përvoja e luftës nuk është diçka që ti do. Asnjë person i arsyeshëm nuk e do atë. Është rikthim në epokën e gurit dhe në kohën e shkëmbimit me mallra. Në luftë mund ta shisje një furçë dhëmbësh, një pastë dhëmbësh ose një thikë xhepi dhe të mbushesh me para. E bëmë këtë një herë: shkuam në një qytet, shumë prapa linjave të luftës, pimë birrë dhe dëgjuam Whitney Houston-in duke kënduar në MTV këngën I Will Always Love You. Nuk është se ishim adhures të Whitney Houston-it. E preferonim rokun granxh, dhe më parë e kemi dëgjuar valën e re, por askush nuk

na pyeste për identitetin muzikor apo diçka tjetër.

As që dinim se nacionalistët serbë na shihnin si “Të tjerët”, për t'u dëbuar nga “trojet serbe”, për t'u vrrarë, për t'u përdhunuar dhe për t'u burgosur në kampet e përqendrimit. Në verën e vitit 1992, kur ushtria dhe policia serbe e pushtuan qytetin e Prijedorit, të gjithë joserbët duhej t'i mbanin shiritat e bardhë dhe t'i varnin çarçafët e bardhë në dritaret e shtëpive dhe të banesave. Gjenocidi nisi atje dhe përfundoi me gjenocidin e dëshmuar nga gjykata – për Srebrenicën e korrikut të vitit 1995. Frazja “kurrë më” u përsërit në kampet e përqendrimit të Prijedorit në verën e vitit 1992 dhe tani po përsëritet në Ukrainë.

Edhe pse unë dhe familja ime, bashkëlufetarët dhe bashkëqytetarët kaluam nëpër vuajtjet më të rënda të mundshme (si refugjatë, ushtarë dhe civilë), kurrë nuk ia lejoja vetes ta urrej një popull të tërë. I kam urryer vetëm ultranacionalistët dhe kriminelët e luftës, por jo serbët tjerë.

Është dashur të luftojmë thjeshtë për mbijetesën tonë. Dhe, kur kështu lufton, kurrë nuk mund të mposhtesh, sepse asnjë ide nuk është më e fortë sesa ideja e jetës tënde. Tash për tash, ukrainasit po bëjnë luftën për jetë e vdekje. Kur nuk ke asgjë tjetër për të humbur pos jetës tënde, atëherë je më i forti. Në vjeshtën e vitit 1995, më në fund arritëm ta rimarrim qytetin tonë. Ishte i rrënuar, por e rindërtuam.

Disa vjet pas luftës ti e kupton se jeta nuk do të jetë kurrë si më parë. Kur e humb jetën normale, ajo kurrë nuk mund të rinovohet më. Për momentin, kjo nuk është ajo që shqetëson popullin e Ukrainës. Ata shpresojnë se lufta do të përfundojë sa më shpejt që është e mundur, por lufta ka logjikën e vet që nuk i ngjan aspak logjikës njerëzore. Agresioni kundër Ukrainës i ka të gjitha karakteristikat e një lufte të

gjatë rrënuese.

Ditën që nisi lufta në Ukrainë, kam shkruar në Twitter se rusët do të bëjnë krime lufte, edhe pse ato ende nuk kishin ndodhur. Për këdo që shikonte dhe dëgjonte Vladimir Putinin, ishte e qartë se së shpejti do të pasojnë lufta dhe mizoritë. Ai iu referua Ukrainës si shtet fals, ndërsa ukrainasve si popull fals.

Sllobodan Millosheviqi dhe Radovan Karaxhiqi thanë të njëjtat gjëra për Bosnje-Hercegovinën dhe për boshnjakët – se ishin të remë dhe se nuk e meritojnë ekzistencën. Këto fjalë më vonë u shndërruan në krimet më të rënda në Evropë – që nga Lufta e Dytë Botërore. Shpresoj se krimet e Ushtrisë ruse nuk do t'i tejkalojnë ato që janë kryer në vendin tim.

Do ta kuptojmë shtrirjen e plotë të mizorive dhe të krimeve të pushtimit rus të Ukrainës, atëherë kur do të përfundojë lufta. Gjëja më e rëndësishme është që makineria ruse e luftës të thyhet dhe të ndalet në Ukrainë. Diktatori e kupton vetëm gjuhën e forcës, ndërsa politika e paqësimit ia forcon pushtetin. Njerëzit në BE duhet të largohen nga hapësira e tyre e rehatisë, sepse kjo është sakrificë që kërkohet nga ta, përderisa ukrainasit luftojnë dhe vdesin për ta ruajtur paqen dhe prosperitetin në BE. Nëse Ukraina mposhtet, nuk do të jetojmë më kurrë në paqen që aktualisht mbizotëron.

Qytetet e Ukrainës do të rindërtohen nga hiri. I gjithë vendi mund të ngrihet përsëri. Ajo që nuk mund të kthehet janë të vdekurit. Këto plagë nuk do të shërohen kurrë, por mundesh dhe duhet të jetosh me to. Trauma e humbjes të shënjon dhe nuk të braktis kurrë. Por, besoj në kurajon dhe guximin e ushtarëve dhe të qytetarëve ukrainas, ashtu siç besoja në veten tonë. Besoj në fitoren e jetës mbi vdekjen. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Unai Emery, trajner i ri i Aston Villas

**BRIMINGHAM, 25 TETOR** - Unai Emery është rikthyer në Premierligë. Aston Villa ka njoftuar zyrtarisht këtë të hënë për arrijtjen e marrëveshjes me ish-trajnerin e Arsenalit. Klubi

anglez nuk ka bërë me dije kohëzgjatjen e kontratës me Emeryn, por ka njoftuar se ai do ta marrë drejtimin e skuadrës nga 1 nëntori. 50-vjeçari së fundmi ishte

trajner te Villarreali në La Liga. Ai te skuadra nga "Villa Park" do ta zëvendësojë Steven Gerrardin, i cili është shkarkuar ditë më parë. Aston Villa raportohet se ka

paguar klauzolën prej 6 milionë eurosh të trajnerit spanjoll. Paga e Unai Emeryt te klubi nga Briminghami është thënë se do të jetë rreth 7 milionë euro në vit.



UEFA.com  
 RESPECT  
 CIMA

## Ballkani - Slavia Praha, caktohen gjyqtarët e ndeshjes

**Prishtinë, 25 tetor (ER)** - Janë caktuar gjyqtarët për takimin Ballkani - Slavia Praha në kuadër të Conference League. Morten Krogh i Danimarkës do të jetë gjyqtar kryesor,

ndërsa do të asistohet nga Rasmussen dhe Dahl. Gjyqtari i katërt në këtë duel do të jetë Mikkel Redder. Ballkani - Slavia Praha të zhvillohet nesër (e enjte) në stadiumin

"Fadil Vokrri" me fillim nga ora 21:00. Ballkani ishte mposhtur 3:2 nga Slavia Praha më 15 shtator. Ballkani dhe Slavia Praha janë në Grupin G dhe kanë nga 4 pikë.

## Zidane po rikthehet

**PARIS, 25 TETOR** - Zinedine Zidane po planifikon rikthimin në futboll në një të ardhme të afërt. Trajneri francez u largua nga Real Madridi në maj të vitit 2021, duke e mbyllur përvojën e dytë me "Los Blancos", pasi konsideroi se ishte një shkëputje në mes të tij dhe bordit të klubit. Sidoqoftë, 50-vjeçari tash është i gatshëm të rikthehet në zejen e trajnerit, derisa këtë e ka thënë në muzeun Grevin në Paris të hënë paradite. "A më mungon ulësja e trajnerit? Jo, unë nuk jam larg, duhet të presim edhe pak. Shpejt, shpejt. Nuk jam larg nga puna si trajner", ka thënë legjenda franceze për "RMC Sport". Zidane e ka drejtuar Realin drejt suksesit të trefishtë radhazi në

Ligën e Kampionëve në periudhën 2015-2018. Gjithashtu, ai ka fituar edhe tituj të kampionit në La Liga me klubin spanjoll. Këtë vit ishte spekuluar se "Zizou" do ta merrte në dorë Paris Saint-Germainin, por një gjë e tillë nuk ndodhi dhe parisienët e angazhuan trajnerin Christophe Galtier. Flitet se Zidane mund ta marrë në dorë Kombëtaren e Francës, duke e pasuar Didier Deschampsin. Ai është lidhur edhe me një angazhim eventual në Manchester United para se "Djajtë e Kuq" ta merrnin holandezin Erik ten Hag. Mbetet të shihet se cili do të jetë destinacioni i radhës për Zinedine Zidanen.



## Mendes po punon për ribashkimin e Ronaldos me Mourinhon

**Manchester, 25 tetor** - E ardhmja e Cristiano Ronaldos ende vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes. Portugezi është gjobitur dhe suspenduar nga skuadra e parë e Manchester Unitedit, pasi nuk kishte pranuar të inkuadrohej si zëvendësues në ndeshjen kundër Tottenhamit

në Premierligë. Ai ende nuk është rikthyer te skuadra e parë teksa spekulimet rreth të ardhmes së tij po vazhdojnë të rriten. Ben Jacobs, duke u bazuar në burimet e tij të afërta me agjentin Jorge Mendes, ka raportuar se nuk përjashtohet mundësia që Ronaldo të ribashkohet me Jose

Mourinhon te Roma sezonin e ardhshëm. Jacobs ka shkruar në "Twitter" se burimet e tij pranë Mendes shohin një "trugë" drejt Romës sezonin tjetër, veçanërisht nëse skuadra italiane siguron kualifikimin për në Ligën e Kampionëve. Sipas gazetarit nga "CBS Sports", nuk

përjashtohet as mundësia që pesë herë fituesi i "Topit të Artë" të transferohet në MLS të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. 37-vjeçari me Manchester Unitedin ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2023. Në marrëveshjen e tij me "Djajtë e Kuq" ekziston edhe opsioni për



zgjatje të bashkëpunimit edhe për një tjetër sezon.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rishpall:

### KONKURS

**Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

#### Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

#### Funksionet e Këshillit :

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;
- Mbikëqyr procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

**Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Ndjaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

#### Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitetet politike.

#### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

#### PROCEDURA E KONKURRIMIT

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 14 nëntor 2022, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

#### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

**Forma e shtypur:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

**Forma elektronike:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova ponovo raspisuje:

### KONKURS

**Za izbor dva (2) člana Nezavisnog nadzornog odbora za Civilnu službu Kosova, iz ne albanske zajednice**

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

#### Sastav Odbora

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova. Od toga, najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

#### Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa, odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

**Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:**

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje deset (10) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje pet (5) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljavanja iz civilne službe.

#### Mandat članova Odbora

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju, da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

#### Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- Curriculum Vitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

#### PROCEDURA KONKURISANJA

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 14. novembra 2022. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

#### Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

**Štampana forma:** u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

**Elektronskom obliku:** internet-stranica Skupštine Republike Kosova - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "VEGA" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810128498 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "VEGA" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810128498 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "VEGA" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810128498 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 25.10.2022 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

**Shpallje Publike****T-22-07**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e zyrave ne Terminalin doganore dhe depos në Industrinë baterive.  
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë  
Data e shpalljes: 25.10.2022  
Sqarimi: deri me 07.11.2022  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 07.11.2022  
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)  
Afati i fundit i dorëzimit: 09.10.2022 në 11:00  
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ZONE PROJEKT" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810038689 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ZONE PROJEKT" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810038689 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "ZONE PROJEKT" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810038689 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- "Perptuum" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330458291

- Parmatec L.L.C nga Prishtina shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 71341593

- Fixhrije Gjilkolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lëshuar në qershor të vitit 1985.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një çift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales